



HULUMTIM MBI PROBLEMET DHE
SFIDAT NË LIDHJE ME STATUSIN
SOCIO-EKONOMIK TË GRAVE TË
PUNËSUARA DHE TË
PAPUNËSUARA NË VERIUN E
KOSOVËS

Mitić Aca, Biljana Jaredić, Miljana Pavićević, Dragana
Stanojević

Mitić Aca, Biljana Jaredić, Miljana Pavićević, Dragana Stanojević

**Hulumtim mbi problemet dhe sfidat në lidhje me statusin socio-ekonomik të grave të
punësuar dhe të papunësuar në veriun e Kosovës**

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

HULUMTIM MBI PROBLEMET DHE SFIDAT NË LIDHJE ME STATUSIN SOCIO-EKONOMIK TË GRAVE TË
PUNËSUARA DHE TË PAPUNËSUARA NË VERIUN E KOSOVËS

Bartësi i projektit: Qendra për përfaqësimin e kulturës demokratike

Titulli i projektit: Hulumtim mbi problemet dhe sfidat në lidhje me statusin socio-ekonomik të grave të punësuara dhe të papunësuara në veriun e Kosovës

Mitrovicë e Veriut, Çika Jovina 3, TC North City, office@acdc-kosovo.org

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

Deklarata e Mohimit: "Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij".

Autorët

Aca Mitić

Aca Mitić është një aktivist afatgjatë i shoqërisë civile dhe që ka përvojë të gjerë në zhvillimin organizativ të organizatave të shoqërisë civile, iniciativat e avokimit dhe menaxhimin e konflikteve. Z. Mitić ka menaxhuar një numër të madh të projekteve të financuara nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, USAID-i, KFOS-i, KCSF-ja dhe një numër i madh i ambasadave në Kosovë. Z. Mitić ka marrë pjesë në "Programin për Liderët e Rinj" të organizuar nga Qendra Veiser për Evropën dhe Euro-Azinë (VCEE) dhe Universiteti i Miçiganit. Ai u diplomua në Shkollën e të Drejtave të Njeriut si pjesë e Programit të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut për Liderët e Rinj.

Ndërsa sa i përket përvojës së fundit, z. Mitić ka punuar në organizatën ndërkombëtare "Helvetas Swiss Intercooperation Kosovo" si këshilltar për performancën komunale të kryetarit të komunës Zveçan në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Biljana Jaredić

Biljana Jaredić është docente në Fakultetin Filozofik në Mitrovicën e Veriut. Si shefe e Departamentit të Psikologjisë, ajo ka realizuar bashkëpunim me departamente të tjera në të gjithë vendin dhe në rajon, gjë që mund të jetë një bazë e mirë për marrjen dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet palëve të ndryshme të interesuara. Ajo po ashtu ka nëntë vjet përvojë në pjesëmarrjen në projekte shkencore të financuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik, të cilat kanë mundësuar zhvillimin e kompetencave në fushën e kërkimit por edhe të projekteve.

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

Dragana Stanojević

Prof. Dr. Dragana Stanojević është profesoreshë e asociuar në fushën e Psikologjisë Klinike (lëndë e rëndësishme për këtë projekt: Bazat e vlerësimit klinik). Ajo është një mësimitdhënëse e akredituar në programet e studimit të studimeve akademike të doktoratës në Pedagogji dhe Sociologji (ku është akredituar edhe si mentore). Përmes përsosjes së njohurive në këtë program, ajo do të përmirësojë avancimin e njohurive edhe në nivele më të larta të studimit. Si prodekane për studimet master dhe ato të doktoratës, ajo do të mundësojë përhapjen e njohurive në nivele të larta të studimeve dhe programeve të tjera të studimit në kuadër të fakultetit.

Miljana Pavićević

Miljana Pavićević është e punësuar në Fakultetin Filozofik në Mitrovicën e Veriut, tani si docente, mësimitdhënëse e lëndëve në fushën e psikologjisë së personalitetit (lëndë e rëndësishme për këtë projekt: Psikologjia e dallimeve individuale). Përmes shumë viteve të punës si edukatore në programet e organizatave të shoqërisë civile, ajo kontribuon për shkëmbimin më të mirë të njohurive ndërmjet komunitetit akademik dhe akterëve të jashtëm.

Hyrje

Në gjashtë muajt e fundit, koronavirusi është bërë pengesa më e madhe me të cilën jemi përballur që nga Lufta e Dytë Botërore. Me më shumë se 6.5 milion njerëz të infektuar në të gjithë botën, kjo nuk është më vetëm krizë shëndetësore. Kudo që kalon, pandemia lë pasojë shkatërruese në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike, për shëndetin e njeriut, si dhe shëndetin mendor.

Përhapja e COVID 19 ka prekur ekonomitë familjare dhe bizneset në Kosovë në shumë mënyra. Nga orari i reduktuar i punës që i uli të ardhurat, lufta me mësimin në distancë dhe ballafaqimi me pengesat psikologjike, shëndetin mendor dhe emocional për shkak të pandemisë – efektet mbi anëtarët e familjes kanë qenë të shumëfishta. Bizneseve u është dashur të merren me vonesat dhe vazhdimësinë e virusit, si ta bëjnë të mundur shëndetin e punëtorëve të tyre, si dhe nëse duhet të realizojnë biznesin e tyre, çfarë dhe si të blejnë, të shesin ose të prodhojnë.¹

Kur ndodh kriza, siç është rasti me pandeminë COVID-19, janë autoritetet lokale ato që dalin në vijën e parë të mbrojtjes së qytetarëve të tyre. Ato ofrojnë shërbime emergjente, komunikojnë me qytetarët për masat për të luftuar përhapjen e virusit dhe sigurojnë që shërbimet që u mundësojnë komuniteteve të funksionojnë të vazhdojnë të ofrojnë shërbime me standardet më të mira.

Në Kosovë, pandemia ishte “krizë brenda krizës” - ndikimet shëndetësore dhe ekonomike dhe kriza kushtetuese. Megjithatë përqindjet e infektimit pandemik dhe e vdekjeve nuk janë aq të larta, disa vlerësime tregojnë se ekonomia e Kosovës do të tkurret me 4.5% në vitin 2020, pas së cilës ajo do të rimëkëmbet në vitin 2021.

Pandemia ka ushtruar presion të madh mbi qeverisjet lokale sa i përket reagimit dhe zvogëlimit të ndikimit që ajo mund të ketë mbi qytetarët. Përveç përgjegjësisë të rregullta, komunat duhet të shtonin punën e tyre për t'i ndihmuar qytetarët më të rrezikuar dhe të angazhoheshin në komunikim të drejtpërdrejtë për të parandaluar përhapjen e pandemisë.

Shërbimet e qeverisjes vendore kanë qenë gjithmonë shumë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve, por asnjëherë më shumë sesa sot gjatë pandemisë COVID-19. Nga njëra anë, komunat

¹ Raporti i Ekipit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën zbulon ndikimin e COVID-19. Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

duhej të reagonin shpejt duke kryer aktivitete që synonin dezinfektimin, pastrimin e rrugëve dhe apartamenteve të banimit. Nga ana tjetër, atyre iu desh të monitoronin fusha të tjera brenda mandatit komunal, siç janë grumbullimi i mbeturinave dhe shërbimet e tjera. Kjo disi i ka detyruar institucionet qendrore dhe lokale që ta zvogëlojnë numrin e nëpunësve shtetërorë dhe të punojnë me personel bazë dhe të kufizuar, gjë që ndikon në efikasitetin e punës nëpër komuna dhe ndoshta në performancën e tyre të përgjithshme.²

Ky hulumtim ka për qëllim të hulumtojë, mbledhë dhe shpërndajë të dhëna përkitazi me problemet dhe sfidat në lidhje me statusin socio-ekonomik të grave të punësuarra dhe të papunësuarra në veri të Kosovës në mënyrë që të hartojë rekomandime për vendim-marrësit në nivelin lokal dhe atë qendror, për mediat dhe organizatat ndërkombëtare.

Hulumtimi ka përfshirë fushat e mëposhtme: Përgjigjet e qeverisë lokale në buxhetimin e përgjegjshëm në aspektin gjinor, pjesëmarrja e grave në proceset vendim-marrëse në nivelin lokal, mundësitë e punësimit në nivelin lokal dhe atë rajonal, problemet në nivel të familjes (pamundësia për t'u kujdesur për fëmijët për shkak të punësimit të të dy prindërve etj), mënyrat moderne për gjetjen e mundësive për punësim online, politikat lokale të punësimit, mundësitë për firmat e vogla fillestare (start-up).

Rezultatet më të rëndësishme

1. 75% e të anketuarave u përgjigjën se nuk ishin të informuara për organizimin e konsultimeve publike nga ana e komunave në veri të Kosovës

2. 63% e të anketuarave u përgjigjën se nuk ishin të informuara se në komunat në veri të Kosovës ekziston një konkurs për fillimin e start-up bizneseve (fillimi i një biznesi të ri, inovativ dhe të qëndrueshëm)

3. 90% e të anketuarave u përgjigjën se nuk kishin dëgjuar që komunat në veri të Kosovës kanë mjete të veçanta në buxhet të cilat janë të ndara për gratë

² <https://www.helvetas.org/en/switzerland/how-you-can-help/follow-us/blog/inclusive-systems/Local-governments-during-COVID-19>

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

4. Problemet më të shpeshta të cekura nga të anketuarat ishin: Kujdesi për fëmijët, mësimdhënia online, problemet financiare, të ardhurat e reduktuara, stresi dhe nervozizmi.

5. 83% e të anketuarave u përgjigjën se gjatë pandemisë së koronavirusit ato përdorin më shumë celularë/pajisje elektronike

6. 63% e të anketuarave u përgjigjën se proceset e punësimit nuk janë të dukshme.

7. 7% e të anketuarave u përgjigjën se ato kishin humbur vendet e tyre të punës gjatë pandemisë Covid-19.

8. 73% e të anketuarave konsiderojnë se krijimi i agjencive private të kërkimit të punës do të mundësonte një qarkullim më të mirë të informative mbi mundësitë e punësimit.


9. 72% u përgjigjën se ishin përfituese të ndihmës financiare shtetërore gjatë pandemisë së koronavirusit.

10. Mënyra në të cilën gratë mund të fuqizohen ekonomikisht pas pandemisë COVID-19, 51% deklaruan se janë grantet, 25 të anketuara ose 21% përmes krijimit të një platformë online të kërkimit të punës, 21 të anketuara ose 18% që institucionet kanë thirrje publike që janë transparente dhe të barabarta për të gjithë, 7 të anketuara ose 6% kreditë për krijimin e mikro-firmave, 3 të anketuara ose 2% punësimi, 1 e anketuar ose 1% punët publike dhe 1 e anketuar ose 1% tha se të gjitha ishin të rëndësishme.

11. Duke përdorur shkallën e kënaqshmërisë me familjen, të anketuarat më të kënaqura janë me atë që i përkasin familjes në përgjithësi dhe se në çfarë shkalle anëtarët e familjes janë të afërt me njëri-tjetrin. Ato më së paku janë kënaqura me mënyrën se si anëtarët e familjes e kalojnë kohën e tyre të lirë dhe jetën shoqërore që kalon familja.


Hulumtim mbi problemet dhe sfidat në lidhje me statusin socio-ekonomik të grave të punësuara dhe të papunësuara në veri të Kosovës

Pyetëtorin e kanë plotësuar gjithsej 191 të anketuara. Sipas vendbanimit, ato ishin shpërndarë si vijon: Zvečan, 58 të anketuara (30%), Mitrovicë, 82 të anketuara (43%), Zubin Potok 26 të anketuara (14%) dhe Leposaviq 25 të anketuara (13%) (Grafiku 1).



Në mjediset urbane jetojnë 142 të anketuara (74%), ndërsa 49 të anketuara (26%) në mjediset rurale. (Grafiku 2). Kështu, $\frac{3}{4}$ e të anketuarave vijnë nga mjedis urban.

2. Grafiku: Lloji i mjedisit




Të anketuarat janë të një moshë mesatare prej 34,88 vjeç. E anketuara më e vjetër është 59 vjeçare, ndërsa më e reja është 19 vjeçare.

Përqindja më e lartë e të anketuarave e kanë të kryer fakultetin (84 të anketuara ose 44%), pastaj me shkollë të mesme (58 të anketuara ose 30%), me shkollë fillore (24 të anketuara ose 13%), me shkollim të lartë (23 të anketuara ose 12%) dhe me studime pasuniversitare (2 të anketuara) ose 1%).

Pra, është fjala për grup moshën më produktive të grave, nga të cilat vetëm 1/3 e kanë të kryer shkollën e mesme, e madje 2/3 e kanë të kryer shkollën e lartë dhe fakultetin.


3. Grafiku: Shkalla e arsimimit



Numri mesatar i viteve të kaluara në arsimim e të anketuarave është 15.32 vjet. Numri minimal i viteve të arsimimit është 8, ndërsa maksimumi është 23 vjet.

Përqindja më e madhe e të anketuarave janë të punësuar (113 të anketuara ose 59%), 5 të anketuara ose 9% punojnë në të zezë, ndërsa 69 të anketuara ose 36% nuk janë të punësuar.

4. Grafiku: Angazhimi në punë



Në pyetjen se kush kujdeset për fëmijët kur jeni në punë, 16 të anketuara ose 16% u përgjigjën se gjyshërit kujdesen për fëmijët, 31 të anketuara ose 32% u përgjigjën se fëmijët janë


Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

në çerdhe, 25 të anketuara ose 26% u përgjigjën se fëmijët janë të pavarur, 18 të anketuara ose 19% u përgjigjen se bashkëshorti kujdeset për fëmijët, 5 të anketuara ose 5% që fëmijët janë në qëndrim të zgjatur dhe 2 të anketuara ose 2% u përgjigjen se një i afërm kujdeset për fëmijët.




147 të anketuara janë të martuara (77%), 19 të anketuara janë beqare (10%), 11 të anketuara janë të shkurorëzuara (6%), 11 të anketuara janë në lidhje (6%), 2 të anketuara janë në bashkësi jashtë-martesore (1%), dhe një e anketuar është e ve.

6. Grafiku: Statusi i lidhjes




155 të anketuara ose 81% kanë fëmijë, ndërsa 36 të anketuara ose 19% nuk kanë fëmijë. Numri mesatar i fëmijëve është 1.75. Në mesin e grave që kanë fëmijë, numri minimal i fëmijëve është 1, dhe maksimumi është 5. Numri mesatar i fëmijëve në arsimin parashkollor të atyre të anketuarave që kanë fëmijë është 0.47. Numri mesatar i fëmijëve në arsimin fillor të atyre të anketuarave që kanë fëmijë është 0.96, ndërsa numri mesatar i fëmijëve në moshën e shkollës së mesme të atyre të anketuarave që kanë fëmijë është 0.28. Mund të vijmë në përfundim se shumica e të anketuarave tona kanë fëmijë dhe se numri më i madh i fëmijëve janë moshës së shkollës fillore, pastaj të moshës parashkollore. Kjo na tregon se ekziston nevoja për t'u kujdesur për ta dhe se ata në përgjithësi nuk janë të pavarur.

7. Grafiku: A keni fëmijë?



Në pyetjen nëse jeni të informuara se në vendin tuaj organizohet debati publik për buxhetin e komunës, 110 të anketuara ose 57% nuk ishin të informuara për organizimin e debatit publik për buxhetin, 55 të anketuara ose 29% e dinin këtë gjë, ndërsa 26 të anketuara ose 14% nuk e dinin ose nuk u kujtohej. Kështu që, pak më pak se 2/3 (dy të tretat) e të anketuarave nuk ishin aspak të njohura me organizimin e debatit publik për buxhetin.

8. Grafiku: Të informuara lidhur me debatin publik për buxhetin




Në pyetjen se si mësuat për këtë, 36 të anketuara ose 52% e mësuat këtë nga rrjetet sociale, 13 të anketuara ose 19% nga miqtë, 12 të anketuara ose 17% nga mediat, 7 të anketuara ose 10%

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"


nga punëtorët e komunës dhe 1 e anketuar ose 2% kishte organizuar debat. Pra, rrjetet sociale kishin pjesën më të madhe në informim, sepse kështu informohet çdo e dyta grua.

8.1. Grafiku: Si keni mësuar për debatin rreth buxhetit?



Në pyetjen nëse jeni të informuara se në vendin tuaj po zhvillohej një konsultim publik për investimet kapitale, 143 të anketuara ose 75% u përgjigjën se nuk ishin të informuara, 27 të anketuara ose 14% nuk e dinin ose nuk u kujtohet, ndërsa 21 të anketuara ose 11% ishin të informuara. Kur bëhet fjalë për investime kapitale, 4 në 5 gra nuk ishin të informuara fare, dhe vetëm çdo e 10 e anketuar ishte e informuar.


9. Grafiku: Të informuara rreth konsultimeve mbi investimet kapitale



Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"


Në pyetjen se si mësuar për debatin publik për investimet kapitale, 11 të anketuara ose 33% e kishin mësuar përmes rrjeteve sociale, 11 të anketuara ose 33% e kishin mësuar nga miqtë, 5 të anketuara ose 15% nga punëtorët e komunës, 5 të anketuara ose 15% nga mediat dhe 1 e anketuar ose 3% kishin organizuar debat. Sërish, rrjetet sociale ishin një nga mjetet kryesore, te çdo e treta grua, ndërsa e dy të tretat tjera u informua përmes përcjelljes së informatave me gojë.

9.1. Grafiku: Si keni mësuar për debatin publik rreth investimeve kapitale?




Në pyetjen nëse jeni informuar që në vendin tuaj po nënshkruhej një peticion, 128 të anketuara ose 67% u përgjigjën se nuk ishin të informuara, 25 të anketuara ose 13% u përgjigjën se nuk e dinin ose nuk u kujtohej dhe 38 të anketuara ose 20% u përgjigjën se ishin të informuara. Vetëm një në pesë gra ishin të informuara për nënshkrimin e peticionit.

10. Grafiku: Informatat lidhur me nënshkrimin e petitionit



Në pyetjen se si e mësuar që në vendin tuaj po nënshkruhej një petition, 28 të anketuara ose 57% e kishin mësuar nga miqtë, 14 të anketuara ose 29% e kishin mësuar përmes rrjeteve sociale, 5 të anketuara ose 10% përmes mediave, 1 e anketuar ose 2% nga punëtorët e komunës dhe 1 e anketuar ose 2% nga organizatorët e petitionit.

10.1. Grafiku: Si keni mësuar për nënshkrimin e petitionit?




Në pyetjen nëse jeni informuar se po zhvillohej një konkurs për punësim në komunën tuaj, 103 të anketuara ose 54% u përgjigjen, 73 të anketuara ose 38% nuk u përgjigjen dhe 15 të

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"


anketuara ose 8% nuk e dinin ose nuk u kujtohej. Vetëm gjysma e grave të anketuara ishin të informuara rreth konkursit për punësim.

11. Grafiku: Informatat rreth konkursit për punësim



Në pyetjen se si e morët vesh për konkursin e punësimit, 53 të anketuara ose 48% e kishin mësuar nga miqtë, 26 të anketuara ose 23% përmes rrjeteve sociale, 22 të anketuara ose 20% përmes mediave, 8 të anketuara ose 7% nga punëtorët e komunës, 1 e anketuar ose 1% përmes faqes zyrtare të internetit dhe 1 e anketuar ose 1% e kishte mësuar vetëm kur dikush ishte punësuar nga partia. Në këtë rast, ato ishin informuar gojarisht nga miqtë, ndërsa çdo e pesta përmes rrjeteve sociale.


11.1. Grafiku: Si keni mësuar rreth konkursit për punësim?



Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

Në pyetjen nëse jeni informuar që në komunën tuaj po fillonte një konkurs për biznes fillestar start-up (fillimi i një biznesi të ri, inovativ dhe të qëndrueshëm), 121 të anketuara ose 63% u përgjigjën se nuk ishin të informuara, 45 të anketuara ose 24% u përgjigjën se ishin të informuara, ndërsa 29 të anketuara ose 13% nuk e dinë ose nuk u kujtohet. Vetëm çdo e katërta grua ishte e informuar për konkursin për fillimin e një biznesi fillestar (start-up).


12. Grafiku: Informatat rreth konkursit për start-up biznesin



■ da ■ ne ■ ne znam/ne se çam se


Në pyetjen se si e morët vesh për konkursin për biznes fillestar (start-up), 20 të anketuara ose 42% nga miqtë, 12 të anketuara ose 25% përmes rrjeteve sociale, 12 të anketuara ose 25% përmes mediave dhe 4 të anketuara ose 8% nga punëtorët e komunës. Sikurse në lidhje me pyetjen e mëparshme, edhe këtu kanali kryesor për transmetimin e informatave këtu ishin miqtë, e më pas rrjetet sociale.

12.1. GRAFIKU: SI KENI MËSUAR RRETH KONKURSIT PËR START-UP BIZNESIN?



Në pyetjen nëse jeni informuar që po zhvillohej një konkurs për ndarje të granteve për gratë në komunën tuaj (nga komuna, donatorë të huaj/vendorë ose ndonjë palë e tretë), 144 të anketuara ose 76% u përgjigjën se nuk ishin të informuara, 31 të anketuara ose 16 % të informuara, dhe 16 të anketuara ose 8% nuk e dinë ose nuk u kujtohet. Sa u përket granteve të destinuara për gratë madje deri në 3 nga 4 sish nuk ishin të informuara.

13. Grafiku: Informatat rreth konkursit për ndarjen e granteve




■ da ■ ne ■ ne znam/ ne se çam se

Në pyetjen se si e morët vesh për konkursin për ndarjen e granteve, 20 të anketuara ose 53% e morën vesh nga miqtë, 12 të anketuara ose 31% përmes rrjeteve sociale, 5 të anketuara ose

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"


13% përmes mediave dhe 1 e anketuar ose 3% nga punëtorët e komunës. Informatat përsëri u mor gojarisht nga miqtë, dhe më pas përmes rrjeteve sociale.

13.1 GRAFIKU: SI KENI MËSUAR RRETH KONKURSIT PËR NDARJEN E GRANTEVE



Në pyetjen nëse keni marrë pjesë në dëgjimet e buxhetit publik të organizuara nga komunat, 180 të anketuar ose 94% u përgjigjën jo, 9 të anketuar ose 5% u përgjigjën po dhe 2 të anketuar ose 1% u përgjigjën se nuk i dinë ose nuk i mbajnë mend.

14. Grafiku: Pjesëmarrja në debatet publike për krijimin e buxhetit




Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

Në pyetjen nëse keni marrë pjesë në debatet publike për investime kapitale në komunën tuaj, 184 të anketuara ose 96% nuk kishin marrë pjesë, dhe 7 të anketuara ose 4% kishin marrë pjesë.

Mund të vijmë në përfundim se një përqindje e papërfillshme e grave kishin marrë pjesë në debatet publike për krijim të buxhetit ose për investime kapitale.


15. Grafiku: Pjesëmarrja në debatet për investimet kapitale



■ da ■ ne

Në pyetjen nëse ishit nismëtare e ndonjë peticioni drejtuar organeve komunale, 180 të anketuara ose 94% u përgjigjën jo, 6 të anketuara ose 3% u përgjigjën po, ndërsa 5 të anketuara ose 2.98% nuk e dinë ose nuk u kujtohet.

16. Grafiku: Iniciuesi i peticionit



Në pyetjen nëse keni qenë nënshkruese e ndonjë peticioni dërguar organeve komunale, 145 të anketuara ose 76% nuk e kishin nënshkruar peticionin, 30 të anketuara ose 16% e kishin nënshkruar, dhe 16 të anketuara ose 8% nuk e dinë ose nuk u kujtohet nëse e kishin nënshkruar peticion.

Kur bëhet fjalë për peticione, një përqindje e papërfillshme e grave ishin organizatore të nënshkrimit, dhe vetëm një në tre sish ishte nënshkruese e peticioneve.


17. Grafiku: Nënshkrues i peticionit



Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"


Në pyetjen nëse keni marrë pjesë në zgjedhjet lokale, 160 të anketuara ose 84% kishin marrë pjesë, 25 të anketuara ose 13% nuk kishin marrë pjesë dhe 6 të anketuara ose 3% nuk e dinë ose nuk u kujtohet se kishin marrë pjesë në zgjedhjet lokale.

18. Grafiku: Pjesëmarrja në zgjedhjet lokale



Në pyetjen, nëse keni marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare, 159 të anketuara ose 83% kishin marrë pjesë, 27 të anketuara ose 14% nuk kishin marrë pjesë, ndërsa 5 të anketuara ose 3% nuk e dinë ose nuk u kujtohet që të kenë marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare.

19. Grafiku: Pjesëmarrja në zgjedhjet parlamentare



Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"


Kur bëhet fjalë për zgjedhjet, nga ana tjetër, përqindja më e madhe e grave të anketuara kishin marrë pjesë.

Në pyetjen nëse ato personalisht e dorëzuan kërkesën në komunë, 108 të anketuara ose 57% u përgjigjën jo, 75 të anketuara ose 39% po, ndërsa 8 të anketuara ose 4% nuk e dinë ose nuk u kujtohet se e kanë dorëzuar kërkesën.




Në pyetjen se për çfarë lloj kërkesë bëhej fjalë, 27 të anketuara ose 37% zgjidhja e çështjes së banimit, 19 të anketuara ose 26% pritje te kryetari i komunës, 11 të anketuara ose 15% për subvencione, 9 të anketuara ose 12% për materiale ndërtimore, 2 të anketuara ose 3% për punë, 2 të anketuara ose 3% ndonjë problem në komunë, 1 e anketuar ose 1% thirrje publike për punë praktikë, 1 e anketuar ose 1% ndihmë për fëmijët me pengesa në zhvillim dhe 1 e anketuar ose 1% subvencione për lindjen e fëmijës.

20.1. Grafiku: Llojet e kërkesave




Në pyetjen nëse ato kishin marrë pjesë në konkursin publik për punësim që ishte në komunën e tyre, 111 të anketuara ose 58% u përgjigjën jo, 74 të anketuara ose 39% po, dhe 6 të anketuar ose 3% nuk e dinin ose nuk u kujtohej. Këto të dhëna tregojnë se gati 6 në 10 gra nuk kanë marrë pjesë në konkurset publike për punësim nëpër komuna.

21. Grafiku: Pjesëmarrja në konkursin për punë



Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"


Në pyetjen nëse ato kishin marrë pjesë në konkursin për “start up” – për fillimin e një biznesi në komunën e tyre, 184 të anketuara ose 96% u përgjigjën jo, dhe 7 të anketuara ose 4% u përgjigjën që kishin marrë pjesë në konkurs.



Në pyetjen nëse ato kishin marrë pjesë në konkurset për ndarje të granteve (në programet posaçërisht për fuqizimin ekonomik të grave) në komunën e tyre, 182 të anketuara ose 96% u përgjigjën se nuk kishin marrë pjesë, ndërsa 8 të anketuara ose 4% se kishin marrë pjesë.


Mund të vihet në përfundim se vetëm një përqindje e papërfillshme e grave kishin pjesë në konkurset për ndarjen e start-up (bizneseve fillestare) ose të grante të destinuara për gratë, dhe madje 9 nga 10 gra nuk kishin dëgjuar se në buxhetin e komunave ndaheshin mjete të veçanta për gratë.

23. Grafiku: Pjesëmarrja në konkurset për ndarje të granteve



Në pyetjen nëse kishin dëgjuar që komuna ka mjete të veçanta në buxhet të ndara për gratë 173 të anketuara ose 90% u përgjigjën se nuk kishin dëgjuar, 9 të anketuara ose 5% u përgjigjën se kishin dëgjuar, dhe 9 të anketuara ose 5% nuk e dinë ose nuk u kujtohet.

24. Grafiku: Informimi lidhur me mjetet e veçanta në buxhetin për gratë



Në pyetjen se sa mjete ishin këto, askush nga të anketuarat nuk dha përgjigje.

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

Në pyetjen nëse gjatë pandemisë COVID-19 keni hasur në ndonjë nga problemet në punë, 82 të anketuara thanë se kishin një problem të vogël për shkak të mësimit online të fëmijëve, 6 të anketuara raportuan se kishin humbur punën, 23 të anketuara se u ishin ulur fitimet, 11 të anketuara se nuk kishin mundur të shlyenin detyrimet e biznesit, 28 të anketuara raportuan një problem në lidhje me kujdesin ndaj fëmijëve, punë jashtë orarit gjatë pandemisë 15 të anketuara, 38 të anketuara raportuan punë të rrezikshme gjatë pandemisë dhe një e anketuar një problem në lidhje me kufizimin e lirisë së lëvizjes.

Në pyetjen nëse ato i kishin humbur vendet e tyre të punës gjatë pandemisë, 177 të anketuara ose 93% u përgjigjën se nuk e kishin humbur, dhe 14 të anketuara ose 7% u përgjigjën se ato e kishin humbur vendin e tyre të punës.




Në pyetjen se si ishin informuar për gjetjen e një shansi për punësim, 77 të anketuara u përgjigjën se ishin informuar përmes të njohurve, 23 të anketuara përmes shërbimit të punësimit, 35 të anketuara përmes rrjeteve sociale, 37 të anketuara përmes faqeve të punësimit, 2 të anketuara përmes mediave ose lajmeve.

Në pyetjen nëse kishin vështirësi me bashkëshortin/fëmijët/familjen gjatë pandemisë COVID-19, të shkaktuara nga humbja e vendit të punës, ulja e fitimeve, pamundësia për t'u kujdesur për fëmijët, mësimi online ose të tjera, 139 të anketuara ose 73% u përgjigjën se jo, 43 të anketuara ose 22% u pajtuan se, ndërsa 9 të anketuara ose 5% nuk e dinë ose nuk u kujtohet.

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

26. Grafiku: Vështirësi në marrëdhëniet me familjen



■ da ■ ne ■ ne znam/ ne se çam se

Problemet më të shpeshta të cekura nga të anketuarit ishin:

- Kujdesi për fëmijët
- Mësimi online
- Problemet financiare

Shembuj të përgjigjeve që i ilustronjë ato probleme janë dhënë në Tabelën 1.

Tabela 1.

Bashkëshorti im punonte në qendrën COVID, kështu që ne ishim më të ekspozuar ndaj rrezikut nga koronavirusi.
Fitimet e reduktuara ...
Nervozizmi
Përplasje me fjalë për shkak të lodhjes
Mungesa e kohës për të arritur gjithçka
Numri i reduktuar i klientëve
Mbingarkesa për shkak të mësimi

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

HULUMTIM MBI PROBLEMET DHE SFIDAT NË LIDHJE ME STATUSIN SOCIO-EKONOMIK TË GRAVE TË PUNËSUARA DHE TË PAPUNËSUARA NË VERIUN E KOSOVËS

Papunësia
Mungesa e kompjuterëve, hapësira e ngushtë në shtëpi
Mosmarrëveshjet me ish-burrin
Ulja e të ardhurave, stresi, nervozizmi
Organizimi, periudha e kufizuar e lëvizjes dhe izolimi.
Mungesa e kohës. Orari i plotë i punës, mësimi online, aktivitete të rregullta, vështirë të përshtaten ...
Kontakti me nxënësit, fëmijë në kushte rurale pa internet.

Në pyetjen se cilat kanë qenë sfidat më të mëdha me të cilat jeni përballur gjatë pandemisë COVID-19, të anketuarat u përgjigjën:

Tabela 2. Sfidat më të mëdha gjatë pandemisë

Përshtatja me mësimin online	1
Përshtatja me punën online	45
Kam qenë e infektuar	1
Presioni nga partneri (fizik, psikik, ekonomik)	1
Papunësia	43
Lëvizja e kufizuar	1
Kalimi i kufirit	1

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

HULUMTIM MBI PROBLEMET DHE SFIDAT NË LIDHJE ME STATUSIN SOCIO-EKONOMIK TË GRAVE TË PUNËSUARA DHE TË PAPUNËSUARA NË VERIUN E KOSOVËS

Transporti	1
Të ardhurat e reduktuara	27
Harmonizimi i obligimeve në lidhje me punën dhe familjen	64

Në pyetjen nëse gjatë pandemisë së koronavirusit ato kanë përdorur më shumë telefonat celularë/pajisjet elektronike, 159 të anketuara ose 83% u përgjigjën po, 26 të anketuara ose 14% u përgjigjën jo, dhe 6 të anketuara ose 3% nuk e dinë ose nuk u kujtohet.



Në pyetjen se kush është përgjegjës që t'ju ndihmojë për të gjetur punë, të anketuarat u përgjigjën: vetëm unë jam përgjegjëse 42, komuna 51, organizatat ndërkombëtare 6, mediat 3, zyra e punësimit 58, rrjetet sociale 5, punëdhënësit 14, të gjithë të cekurit 1, shteti 1.

Në pyetjen nëse në komunën tuaj ka agjenci private të punësimit, 85 të anketuara ose 45% nuk u përgjigjën, NUK E DI 102 të anketuara ose 53% dhe PO u përgjigjën 4 të anketuara ose 2%.


Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

28. Grafiku: Ekzistimi i agjencive private



Në pyetjen “Nëse jo, a mendoni se krijimi i agjencive private të kërkimit të punës do të mundësonte një qarkullim më të mirë të informatave mbi mundësitë e punësimit?” PO u përgjigjën 111 ose 73% e të anketuarave, JO u përgjigjën 11 të anketuara ose 7%, ndërsa 30 të anketuara ose 20% u përgjigjën NUK E DI.


29. Grafiku: Themelimi i agjencive për qarkullim më të mirë të informatave



Projekti është financuar nga “Demokracia për Zhvillim” si pjesë e projektit ‘Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës’ mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. “Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij”


Në pyetjen nëse proceset e punësimit janë transparente (të dukshme për publikun) PO u përgjigjën 22 të anketuara ose 12%, NUK E DI u përgjigjën 48 të anketuara ose 25%, ndërsa 121 të anketuara ose 63% u përgjigjën se proceset e punësimit NUK JANË TË DUKSHME.

30. Grafiku: A janë transparente proceset e punësimit?



Në pyetjen nëse keni qenë përfituese e ndihmës financiare shtetërore gjatë pandemisë COVID-19, 137 të anketuara ose 72% u përgjigjën se ishin përfituese të ndihmës financiare, 49 të anketuara ose 26% nuk ishin përfituese dhe 5 të anketuara ose 2% nuk dinin nëse ishin shfrytëzuese.


31. Grafiku: A keni qenë shfrytëzuese e ndihmës financiare gjatë pandemisë?



Nga 191 të anketuara, 128 ishin përfituese të ndihmës financiare nga Beogradi, dhe 29 nga Prishtina.

Në pyetjen se si konsideroni se gratë mund të fuqizohen ekonomikisht pas pandemisë COVID-19, 61 të anketuara ose 51% thanë se përmes granteve, 25 të anketuara ose 21% duke krijuar një platformë online për kërkim të punës, 21 të anketuara ose 18% që institucionet kanë thirrje publike që janë transparente dhe të barabarta për të gjithë, 7 të anketuara ose 6% përmes kredive për krijimin e mikro-firmave, 3 të anketuara ose 2% përmes punësimit, 1 e anketuar ose 1% përmes punëve publike dhe 1 të anketuar ose 1% tha se të gjitha këto ishin të rëndësishme.

32. Grafiku: Fuqizimi ekonomik i grave pas pandemisë



Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

Të anketuarat u pyetën sipas *Shkallës së kënaqshmërisë familjare* gjatë pandemisë COVID-19. Shkalla përbëhet nga 10 pika në të cilat të anketuarat u përgjigjen nga 1 - plotësisht të pakënaqura deri në 7 - plotësisht të kënaqura me disa aspekte të funksionimit të familjes gjatë pandemie. Rezultati minimal në shkallë ishte 16, ndërsa maksimal 70. Kënaqshmëria mesatare me funksionimin e familjes gjatë pandemisë në mesin e të anketuarave ishte 58.80, që është më e ulët krahasuar me hulumtimet e mëparshme të përfituara sipas kësaj shkalle, që ishte 60.94 (Pavićević dhe Krstić, 2014).

Të anketuarat më të kënaqura janë me përkatësinë familjare në përgjithësi dhe shkallën në të cilën anëtarët e familjes janë afër njëri-tjetrit. Ato, më pak të kënaqura janë me mënyrën se si anëtarët e familjes e kalojnë kohën e tyre të lirë dhe jetën shoqërore që e kalon familja.

Tabela 2. Kënaqshmëria në familje

	N	Minimumi	Maksimumi	Mesatarja	Devijimi Std.
A jeni e kënaqur me mënyrën e rritjes së fëmijëve në familjen tuaj?	191	1	7	5.83	1.521
A jeni e kënaqur me stilin e jetës së familjes tuaj?	191	1	7	5.55	1.534
A jeni e kënaqur me mundësinë për të shprehur atë që ndjeni në familjen tuaj?	191	1	7	6.11	1.319

HULUMTIM MBI PROBLEMET DHE SFIDAT NË LIDHJE ME STATUSIN SOCIO-EKONOMIK TË GRAVE TË PUNËSUARA DHE TË PAPUNËSUARA NË VERIUN E KOSOVËS

A jeni e kënaqur me shkallën në të cilën anëtarët e familjes janë afër njëri-tjetrit?	191	1	7	6.13	1.344
A jeni e kënaqur me mënyrën se si familja juaj e kalon kohën e lirë?	191	1	7	5.31	1.591
A jeni e kënaqur me mënyrën se si anëtarët e familjes suaj komunikojnë me njëri-tjetrin?	191	1	7	5.86	1.503
A jeni e kënaqur me mënyrën se si familja juaj sillet me dëshirat e të gjithë anëtarëve të saj?	191	1	7	5.85	1.404
A jeni e kënaqur me jetën shoqërore që bën familja juaj?	191	1	7	5.48	1.436
A jeni e kënaqur me mënyrën se si familja juaj përshtatet me fqinjët?	191	1	7	6.02	1.304
A jeni e lumtur që i përkisni familjes tuaj?	191	2	7	6.69	.892

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

Rekomandime

Rekomandime drejtuar institucioneve në nivelin qendror

1. Ofroni ndihmë të vazhdueshme financiare për organizatat e punës me qëllim që të mbuloni kostot e tyre fikse dhe operative përmes granteve ose t'u mundësoni shfrytëzimin e kredive të përballueshme.
2. Krijoni programe mbështetëse inovative për të kapërcyer krizën financiare të shkaktuar nga koronavirusi që do t'u mundësonte organizatave të punës mbajtjen e punëtorëve gjatë krizës.
3. Krijoni mekanizma koordinimi në kuadër të nismave të ndryshme qeveritare dhe zhvilloni partneritete të reja në mënyrë që të krijoni zgjidhje të reja dhe inovacione shoqërore.
4. Krijoni programe mbështetëse në formën dhënies së mjeteve pa kthim dhe të qasjes në hua që do të ishin të destinuara për organizatat punuese që drejtohen nga gratë me fokus në zhvillimin e modeleve të reja të biznesit, shkathtësive dhe inovacioneve.
5. Hulumtoni nevojën për masa mbështetëse shtesë për ndërmarrjet që drejtohen nga gratë, të rinjtë dhe grupet shoqërore të cënueshme dhe siguroni programe punësimi që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit si dhe të sigurohen investime në inovacion dhe mbështetje financiare për sipërmarrjet e grave përmes qasjes më të madhe në rrytet teknike, shkencore, inovative dhe të përgjithshme të biznesit.
6. Të rritet fokusi në bashkëpunimin ekonomik përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor si dhe përmes fondeve të tjera në dispozicion

Rekomandime drejtuar organizatave të shoqërisë civile

1. Siguroni informacion mbi programet e qasshme të mbështetjes për zhvillimin e afarizmit nga donatorët qeveritarë ose joqeveritarë, si dhe udhëzues për nxitjen e bashkëpunimit me të gjithë akterët e interesuar dhe përdorimin e teknologjive të TI-së për të përmirësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve ose të marketingut.
2. Mbështetje në zhvillimin e aftësive të nevojshme për të përshtatur punën me situatën aktuale përmes ndërtimit të kapaciteteve në fushën e teknologjisë së informacionit, p.sh. puna online ose përshtatja e prodhimit dhe shitjeve duke përdorur teknologjitë TI-së për nevojat e marketingut.
3. Të avokoni për publikim transparent dhe të përgjegjshëm të thirrjeve publike nga qeveritë lokale në mënyrë që të krijohen mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët.
4. Krijoni propozime dhe aktivitete të projekteve duke përdorur hulumtime që pasqyrojnë situatën reale në terren dhe që përputhet me situatën aktuale të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.
5. Përmirësoni komunikimin ndërmjet sektorit të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile me qëllim të promovimit të konceptit të përgjegjësisë shoqërore të korporatave përmes së cilës organizatat e shoqërisë civile do të siguronin vazhdimësi sa i përket ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë hartëzimin dhe kontaktimin e grupeve më të rrezikuara, sigurimin e ndihmës për grupet në nevojë dhe forcimin e partneriteteve ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, institucioneve në nivelin lokal/qendror, organizatave ndërkombëtare dhe sektorit të biznesit.

Projekti është financuar nga "Demokracia për Zhvillim" si pjesë e projektit 'Adresimi i pasojave të COVID-19 në të drejtat e grave në tregun e punës' mbështetur nga Trusti i Ballkanit për Demokraci. "Opinionet e shprehura në këtë punim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Institutit Demokraci për Zhvillim, Trusti Ballkanit për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij"

Rekomandime drejtuar institucioneve në nivelin lokal

1. Krijoni metodologjinë për vlerësimin e shpejtë të nevojave të komuniteteve, si dhe të metodologjive të tjera kualitative për mbledhjen e të dhënave dhe veçanërisht përfshini gratë dhe grupet e tjera në nevojë, në mbledhjen e të dhënave për nevojat e tyre në mënyrë që të krijoni politika lokale që i pasqyrojnë nevojat e komuniteteve.
2. Përmirësoni pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendim-marrjes në të cilin qytetarët do të merrnin pjesë në krijimin e planeve dhe masave për rimëkëmbjen ekonomike dhe sociale si dhe forcimin e partneriteteve ndërmjet institucioneve dhe OJQ-ve në mënyrë që të mobilizojnë më shumë komunitetin dhe ofrimin e shërbimeve.
3. Siguroni mbështetje të vazhdueshme për institucionet e nivelit qendror sa i përket komunikimeve të krizës me qëllim që të ruani besimin për një përgjigje të përbashkët, të koordinuar për COVID-19.
4. Bëni përpjekje që të informoni me kohë dhe me vërtetësi qytetarët në lidhje me situatën epidemiologjike dhe vendimet e shtabit të krizës, të gjitha këto me qëllim të zvogëlimit të lajmeve të rreme, stigmatizimit dhe keqinformimit të mundshëm që mund të çojnë në pasoja sociale dhe ekonomike.
5. Mbështetni sipërmarrjen, solidaritetin dhe vullnetarizmin e grave, si dhe zhvillimin strategjik lokal dhe menaxhimin e mirë.
6. Mbështetni mekanizmat e ndryshëm për përmirësimin e dialogut dhe të komunikimit ndërmjet qytetarëve dhe vendim-marrësve.